



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 65

Tiranë – E premte, 29 prill 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 31/2022, datë 31.3.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 12.3.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’”..... 8457
Ligj nr. 32/2022, datë 31.3.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 12.3.2022, “Për një ndryshim në ligjin nr. 113/2021, ‘Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, të ndryshuar”..... 8457
Ligj nr. 33/2022, datë 31.3.2022	Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik..... 8457
Ligj nr. 34/2022, datë 31.3.2022	Për përcaktimin e procedurës së veçantë, për negocimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Jones Group International”, për forcimin e sigurisë kibernetike..... 8464
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 21.4.2022	Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2022..... 8467
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 241, datë 14.4.2022	Për një ndryshim në urdhrin nr. 25, datë 17.1.2019, “Për miratimin e rregullores për publicitetin e barnave”..... 8468
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 242, datë 14.4.2022	Për miratimin e listës së barnave që tregtohen në agjencitë farmaceutike..... 8468
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 243, datë 14.4.2022	Për përcaktimin e barnave që mjekët dhe stomatologët ruajnë në klinikat e tyre..... 8474
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5491, datë 22.4.2022	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Bashkimin Evropian..... 8474

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5497, datë 26.4.2022	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	8474
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 13.4.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2021.....	8475
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 13.4.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2021.....	8477
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 13.4.2022	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2021.....	8480
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 13.4.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	8483
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 13.4.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2000 kw.....	8484
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 72, datë 13.4.2022, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022.....	8486
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 73, datë 13.4.2022, “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022.....	8487
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, “Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.5.2022–31.12.2022”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022.....	8487

**LIGJ**
Nr. 31/2022**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3,
DATË 12.3.2022, “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 115/2021, ‘PËR BUXHETIN
E VITIT 2022’”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 12.3.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, ‘Për buxhetin e vitit 2022’”.

ZËVENDESKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miratur në datën 31.3.2022.

LIGJ
Nr. 32/2022**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 4,
DATË 12.3.2022, “PËR NJË NDRYSHIM
NË LIGJIN NR. 113/2021, ‘PËR NJË
NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8438, DATË
28.12.1998, ‘PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 12.3.2022, “Për një ndryshim në ligjin nr.

113/2021, ‘Për një ndryshim në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, të ndryshuar”.

ZËVENDESKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)

Miratur në datën 31.3.2022.

LIGJ
Nr. 33/2022**PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE
RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT
TË SEKTORIT PUBLIK¹**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e bazës ligjore për promovimin e përdorimit të të dhënave të hapura në Republikën e Shqipërisë me synim nxitjen e inovacionit në ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për të drejtën e ripërdorimit të të dhënave të hapura për qëllime fitimi ose jo të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me: direktivën (BE) 2019/1024 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, numri CELEX 32019L1024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 172, datë 26.6.2019, f. 56–83.



publik ose sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për ripërdorimin e:

a) dokumenteve ekzistuese që mbahen nga organet e sektorit publik;

b) dokumenteve ekzistuese që mbahen nga sipërmarrjet publike:

i. që kryejnë veprimtari sektoriale sipas ligjit për prokurimet publike në ofrimin e shërbimeve të interesit të përgjithshëm në sektorët e ujit, të energjetikës, të transportit dhe të shërbimeve postare;

ii. veprojnë si operatorë të shërbimeve të transportit publik, rrugor, ajror e detar;

c) të dhënave kërkimore, si: statistika, rezultate eksperimentesh, matje, vëzhgime që vijnë nga puna në terren, rezultate anketimesh, regjistrime intervistash e imazhe, duke përfshirë edhe të dhënat meta (metadata), specifikime dhe objekte të tjera digjitale në përputhje me parashikimet e nenit 13 të këtij ligji.

Neni 4

Kufizime

1. Ky ligj nuk zbatohet për dokumente:

a) ofrimi i të cilave është jashtë objektit të veprimtarisë së organit përkatës të sektorit publik;

b) të sipërmarrjeve publike të parashikuara në shkronjën “b” të nenit 3 të këtij ligji kur ato janë hartuar përtej objektit të ofrimit të shërbimit të interesit të përgjithshëm ose që nuk janë subjekt i rregullave të prokurimit sipas legjislacionit për prokurimin publik;

c) për të cilat palët e treta kanë të drejta të pronësisë intelektuale;

ç) që përmbajnë të dhëna sensitive, përfshirë edhe ato që përjashtohen për arsye të:

i. mbrojtjes së sigurisë kombëtare, të mbrojtjes ose të sigurisë publike;

ii. konfidencialitetit statistikor;

iii. konfidencialitetit të të dhënave tregtare ose profesionale të kompanive/shoqërive tregtare;

d) aksesit i të cilave është i përjashtuar apo i kufizuar për shkak të mbrojtjes së infrastrukturës kritike me të dhëna sensitive;

dh) aksesit i të cilave është i kufizuar sipas ligjit për të drejtën e informimit, përfshirë rastet ku qytetarët apo personat juridikë duhet të provojnë një interes të veçantë për të aksesuar dokumentet;

e) si: logo, stema ose shenja;

ë) aksesit i të cilave është i përjashtuar ose i kufizuar nga zbatimi i rregullave të aksesit për qëllim të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe pjesë të dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale, ripërdorimi i të cilave nuk është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;

f) të Radiotelevizionit Publik Shqiptar (RTSH) dhe të institucioneve të varësisë së tij në kuadër të përmbushjes së funksionit të shërbimit të transmetimit publik;

g) të institucioneve kulturore, duke bërë përjashtim nga këto institucione bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat;

gj) të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe institucioneve të arsimit të lartë;

h) që janë në zotërim të organizatave të cilat kryejnë kërkime shkencore dhe të organizatave të financimit të kërkimeve, përfshirë organizatat e themeluara për transferimin e rezultateve të kërkimeve, përveç atyre të përcaktuara në shkronjën “c” të nenit 3 të këtij ligji.

Neni 5

Lidhja me ligjet e tjera

1. Ky ligj mbështetet në dispozitat ligjore që rregullojnë të drejtën për akses në dokumente dhe nuk përcakton të drejta shtesë për akses në informacion, në tejkalim të dispozitave në fjalë.

2. Dispozitat e ligjit për të drejtën e informimit nuk preken nga ky ligj. E njëjta vlen edhe për detyrimet ligjore për mbrojtjen e konfidencialitetit.

3. Ky ligj nuk cenon mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe mbrojtjen e privatësisë në komunikimet elektronike.

4. Ky ligj nuk cenon të drejtat e pronësisë intelektuale të rregulluara sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, si dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare për pronësinë intelektuale, ku Republika e Shqipërisë është palë.



5. Të drejtat e pronësisë intelektuale të palëve të treta për krijimin e databazave nuk preken nga ky ligj.

6. Rregullat e përcaktuara në këtë ligj për ripërdorimin e dokumenteve të organeve të sektorit publik dhe të sipërmarrjeve publike përfshijnë edhe dokumentet për të cilat zbatohet ligji për të dhënat gjeohapësinore.

Neni 6 Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Anonimizim” është procesi i ndryshimit të dokumenteve në mënyrë që dokumenti të mos lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm, ose procesi i bërjes së të dhënave personale anonime në mënyrë të tillë që subjekti i të dhënave të mos jetë më i identifikueshëm.

2. “Dokument” është çdo përmbajtje, pavarësisht formatit (shkresor ose elektronik, regjistrim zanor, pamor ose audioviziv), ose çdo pjesë e këtyre përmbajtjeve.

3. “Format i lexueshëm nga kompjuteri” është formati i strukturuar në mënyrë të tillë që programet informatike të mund të identifikojnë, të njohin e të ekstrahojnë lehtësisht të dhëna të caktuara, përfshirë deklaratat individuale dhe strukturën e tyre të brendshme.

4. “Grupe të dhënash me vlerë të madhe” janë dokumente, ripërdorimi i të cilave lidhet me përfitime të rëndësishme për shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë, veçanërisht në krijimin e shërbimeve dhe të aplikacioneve me vlerë të shtuar, hapjen e vendeve të punës të përshtatshme dhe me cilësi të lartë, si dhe për shkak të numrit të përfituesve të mundshëm të shërbimeve dhe aplikacioneve me vlerë të shtuar të bazuara në këto grupe të dhënash.

5. “Institucione të arsimit të lartë” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit të zbatueshëm për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

6. “Licencë standarde” është tërësia e kushteve të ripërdorimit të paracaktuara në një format digjital që i bëhen të njohura aplikantit në momentin e kërkesës për ripërdorim.

7. “Metadata” është çdo e dhënë që jep informacion për të dhëna të tjera.

8. “Ndërfaqe e programimit të aplikimit (API)” është ndërfaqe *software*-i për bashkëveprimin ndërmjet sistemeve, i cili lejon shkëmbim informacioni midis sistemeve dhe aplikacioneve.

9. “Organet e sektorit publik” përfshin çdo organ të pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative; çdo organ të enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ të pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ të Forcave të Armatosura, për aq kohë sa kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdolloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike.

10. “Palë e tretë” është çdo person fizik apo juridik, përveç një organi të sektorit publik ose të një sipërmarrjeje publike që zotëron të dhëna.

11. “Ripërdorimi” është përdorimi nga ana e personave fizikë ose juridikë i dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik në kuadër të detyrës publike ose sipërmarrjeve publike në kuadër të shërbimeve që ato ofrojnë, për qëllime tregtare ose jo, të ndryshme nga qëllimi fillestar për të cilin dokumenti është prodhuar. Shkëmbimi i dokumenteve ndërmjet organeve të sektorit publik ose ndërmjet sipërmarrjeve publike dhe organeve të sektorit publik në përmbushje të detyrave publike të organeve të sektorit publik nuk përbën ripërdorim.

12. “Sipërmarrje publike” është çdo sipërmarrje që vepron në fushat e përcaktuara në shkronjën “b” të nenit 3 të këtij ligji, mbi të cilën organet e sektorit publik mund të ushtrojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi një ndikim dominues për shkak të pronësisë që kanë mbi të, të pjesëmarrjes së tyre financiare në të apo nëpërmjet rregullave që e qeverisin atë. Ndikimi i organeve të sektorit publik në sipërmarrje publike vlerësohet kur organet e sektorit publik, drejtpërdrejt apo tërthorazi:

- a) kanë shumicën e aksioneve të sipërmarrjes;
- b) kontrollojnë shumicën e votave lidhur me aksionet e hedhura në treg nga sipërmarrja;
- c) mund të emërojnë më shumë se gjysmën e organit administrativ, drejtues apo mbikëqyrës të sipërmarrjes.

13. “Standard i hapur zyrtar” është standardi i përcaktuar me shkrim, i cili detajon specifikimet



për kërkesat lidhur me sigurimin e ndërveprueshmërisë së programeve kompjuterike.

14. “Të dhëna dinamike” janë dokumente në formë digjitale, që u nënshtrohen përditësimeve të shpeshta ose në kohë reale, në veçanti për shkak të paqëndrueshmërisë së tyre ose vjetërimit të shpejtë. Të dhënat e gjeneruara nga sensorët zakonisht konsiderohen të dhëna dinamike.

15. “Të dhëna të hapura” është format i pavarur nga platforma, i vënë në dispozicion të publikut pa asnjë kufizim që pengon ripërdorimin e dokumenteve.

16. “Të dhëna kërkimore” janë dokumente në format digjital, si: statistika, rezultate eksperimentesh, matje, vëzhgime që vijnë nga puna në terren, rezultate anketimesh, regjistrime intervistash dhe imazhe, duke përfshirë edhe të dhënat meta (metadata), specifikime dhe objekte të tjera digjitale, përveç publikimeve shkencore, të cilat mbliidhen ose krijohen gjatë veprimtarive të kërkimit shkencor dhe përdoren si provë në procesin kërkimor.

17. “Të dhëna personale” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit të zbatueshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

18. “Të dhëna sensitive” ka të njëjtin kuptim me atë të ligjit të zbatueshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

19. “Veprimtari sektoriale” është veprimtari nga fusha e prokurimit në sektorët e ujit, energjetikës, transportit e shërbimeve postare, të cilat rregullohen sipas ligjit për prokurimin publik.

KREU II KËRKESAT PËR RIPËRDORIM

Neni 7 E drejta për ripërdorim

1. Çdo person gëzon të drejtën të ripërdorë dokumente ekzistuese të organit të sektorit publik për qëllime fitimi ose jo, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Në rastet kur lejohet ripërdorimi për dokumente që bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat, zotërojnë të drejta të pronësisë intelektuale dhe për dokumentet e zotëruara nga sipërmarrjet publike, ripërdorimi i këtyre dokumenteve për qëllime fitimi ose jo bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Organi i sektorit publik përcakton listën e dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura, të cilën e bën publike.

4. Për qëllime të ripërdorimit të dokumenteve, organi i sektorit publik nuk është i detyruar të krijojë, të përshtat dokumente ose të ofrojë ekstrakte në ato raste kur kjo kërkon përpjekje të konsiderueshme shtesë dhe joproporcionale që shkojnë përtej funksionit të zakonshëm.

Neni 8 Trajtimi i kërkesës

1. Organet e sektorit publik e trajtojnë kërkesën për ripërdorim duke i vënë në dispozicion dokumentin për ripërdorim kërkuesit sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, organet e sektorit publik trajtojnë kërkesën për ripërdorim me mjete elektronike.

2. Afati i parashikuar në pikën 1 të këtij neni mund të zgjatet me jo më shumë se 20 ditë pune në rast të kërkesave voluminoze apo të ndërlikuara. Në këto raste, kërkuesi njoftohet se nevojitet më shumë kohë për trajtimin e saj brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Organi i sektorit publik, i cili refuzon një kërkesë për ripërdorim, informon kërkuesin me shkrim lidhur me arsyet e refuzimit.

4. Sipërmarrjet publike dhe institucionet arsimore, organizatat që kryejnë kërkime dhe organizatat që financojnë kërkime nuk kanë detyrimin për të zbatuar këtë nen.

KREU III KUSHTET PËR RIPËRDORIM

Neni 9 Formati i dokumenteve

1. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike vënë në dispozicion një dokument në formatin e gjuhën që zotërohet, në datën e kërkesës për ripërdorim e, kur është e mundur dhe e përshtatshme, përmes mjeteve elektronike në format të hapur, të lexueshëm nga kompjuterët, të aksesueshëm dhe të ripërdorshëm, së bashku me metadatat e tij.



2. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, kur është e mundur, hartojnë dhe bëjnë të disponueshme dokumentet për ripërdorim që nga faza e hartimit ose krijimit të tyre.

3. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike nuk janë të detyruara të vijojnë prodhimin dhe ruajtjen e një lloji të caktuar dokumenti vetëm për ripërdorimin e tij nga një institucion i sektorit publik apo privat.

4. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, për aq sa është e mundur teknikisht, i bëjnë të disponueshme të dhënat për ripërdorim menjëherë pas mbledhjes, përmes ndërfaqeve të përshtatshme API, në formë dinamike ose kur është e përshtatshme, si një shkarkim i vetëm voluminoz (*bulk download*).

5. Në rastet kur vënia në dispozicion e të dhënave dinamike për ripërdorim nga organi i sektorit publik, sipas përcaktimit të pikës 4 të këtij neni, nuk është e mundur për arsye teknike ose financiare, këto të dhëna dinamike bëhen të disponueshme për ripërdorim brenda afatit të përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

Neni 10

Kostoja e ripërdorimit

1. Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, ofrohet pa pagesë.

2. Ripërdorimi i dokumenteve mund të bëhet kundrejt një tarife për të mbuluar kostot shtesë për arsye të riprodhimit, ofrimit e shpërndarjes së dokumenteve, për anonimizimin e të dhënave personale, si dhe për masat e marra për të mbrojtur informacionin sekret tregtar.

3. Bëjnë përjashtim nga ofrimi i dokumenteve pa pagesë:

a) organet e sektorit publik, të cilat, sipas legjislacionit të posaçëm për funksionimin e tyre, sigurojnë të ardhura për të mbuluar një pjesë të konsiderueshme të kostove që lidhen me kryerjen e detyrave të tyre publike;

b) bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat;

c) sipërmarrjet publike.

4. Të ardhurat nga ofrimi dhe lejimi i ripërdorimit të dokumenteve nuk mund të jenë më të larta se kostoja administrative për mbledhjen, prodhimin, riprodhimin, shpërndarjen e ruajtjen e të dhënave, dhe, në rastet që gjen zbatim,

anonimizimin e të dhënave personale dhe masat e marra për mbrojtjen e informacionit sekret tregtar.

5. Për çdo rast ku aplikohet tarifa, metodologjia, masa dhe përdorimi i tarifës duhet të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Organi i sektorit publik që aplikon tarifa për të drejtën e ripërdorimit e bën atë publike në faqen e vet të internetit, si dhe në portalin unik qeveritar të të dhënave të hapura.

Neni 11

Licenca standarde

1. Ripërdorimi i dokumenteve, si rregull, është i hapur dhe vendosja e kushteve bëhet në rastet e justifikuara për interesin publik. Kushtet për ripërdorimin e dokumenteve duhet të jenë objektive, proporcionale dhe jodiskriminuese.

2. Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur ose kundrejt aplikimit të licencës standarde. Në rastin e aplikimit të licencës standarde, licenca ofrohet në formatin elektronik sipas modelit të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Licenca standarde përcakton të drejtat e kufizimet e ripërdorimit, si: për printimin, kopjimin, përpunimin e të dhënave, lejimin ose jo të transferimit të palë të treta, kërkesat për respektimin e pronësisë intelektuale dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12

Lehtësimi i kërkimit të të dhënave të hapura

1. Me qëllim lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura të ofruara nga organet e sektorit publik, krijohet/funksionon portali i të dhënave të hapura qeveritare.

2. Me vendim të Këshillit të Ministrave miratohen rregulla praktike për lehtësimin e kërkimit të të dhënave të hapura.

Neni 13

Të dhënat kërkimore

1. Të dhënat kërkimore të financuara me fonde publike janë të disponueshme për ripërdorim me qëllim fitimi ose jo.



2. Të dhënat kërkimore vihen në dispozicion duke respektuar të drejtat e pronësisë intelektuale, mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, sigurinë e interesat tregtare legjitime.

3. Detyrimet që lindin nga ky nen zbatohen vetëm për ato të dhëna kërkimore nga momenti që ato bëhen publike nga studiuesit, organizatat e kryerjes së kërkimeve ose organizatat e financimit të kërkimeve.

Neni 14 **Mosdiskriminimi**

1. Të gjitha kushtet në fuqi për ripërdorimin e dokumenteve zbatohen në mënyrë të njëjtë dhe nuk janë diskriminuese për kategoritë e ngjashme të ripërdorimit, përfshirë ripërdorimin ndërkufitar.

2. Nëse dokumentet ripërdoren nga një organ i sektorit publik si material për veprimtaritë e veta tregtare, që janë jashtë objektit të detyrave të veta publike, të njëjtat tarifa dhe kushte të tjera që zbatohen për përdoruesit e tjerë zbatohen edhe për dokumentet e kërkuara për këto veprimtari.

Neni 15 **Marrëveshjet ekskluzive**

1. Ripërdorimi i dokumenteve është i hapur për të gjithë.

2. Marrëveshjet dhe kontratat e tjera ndërmjet organeve të sektorit publik ose sipërmarrjeve publike që zotërojnë dokumente dhe palëve të treta nuk duhet të garantojnë asnjë të drejtë ekskluzive për ripërdorim.

3. Pika 2 e këtij neni nuk gjen zbatim në rastet kur është e nevojshme një e drejtë ekskluzive për ofrimin e një shërbimi me interes publik, arsyeja për dhënien e së cilës shqyrtohet rregullisht, jo më pak se një herë në çdo 3 vjet. Marrëveshjet ekskluzive të nënshkruara nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në vijim bëhen publike në internet të paktën 2 muaj para hyrjes së tyre në fuqi. Kushtet përfundimtare të këtyre marrëveshjeve janë transparente dhe bëhen publike në internet.

4. Kur e drejta ekskluzive lidhet me digjitalizimin e burimeve kulturore, periudha e ekskluzivitetit nuk duhet t'i kalojë 10 vjetët. Kur ajo i kalon 10 vjetët, kohëzgjatja shqyrtohet gjatë vitit të 11-t dhe, nëse është rasti, çdo 7 vjet pas tij.

5. Marrëveshjet ligjore, që, pa dhënë shprehimisht një të drejtë ekskluzive, synojnë ose mund të çojnë në vënien në dispozicion në mënyrë të kufizuar të ripërdorimit të dokumenteve nga subjekte të tjera përveç palëve të treta që marrin pjesë në marrëveshje, bëhen publike në internet të paktën 2 muaj para hyrjes në fuqi të tyre.

6. Efekti i këtyre marrëveshjeve ligjore për disponueshmërinë e të dhënave për ripërdorim vlerësohet çdo 3 vjet.

KREU IV GRUPET E TË DHËNAVE ME VLERË TË MADHE

Neni 16 **Kategoritë tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe**

1. Në grupin e të dhënave me vlerë të madhe përfshihen të dhëna në fushat:

- a) gjeohapësinore;
- b) mjedisore dhe të vëzhgimit të tokës;
- c) meteorologjike;
- ç) statistikore;
- d) e shoqërive tregtare dhe pronësisë në këto shoqëri;
- dh) e transportit publik.

2. Me vendim të Këshillit të Ministrave shtohen kategori tematike të grupeve të të dhënave me vlerë të madhe sa herë është e nevojshme, me qëllim reflektimin e zhvillimeve teknologjike dhe zhvillimeve të tregut.

Neni 17 **Ripërdorimi i grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe**

1. Për çdo kategori të të dhënave me vlerë të madhe për ekonominë dhe shoqërinë nga organi/et publike përgjegjëse, në koordinim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përcaktohen grupet specifike të këtyre të dhënave.

2. Grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe duhet të jenë:

- a) të disponueshme pa pagesë;
- b) të lexueshme nga kompjuteri;
- c) të ofruara përmes API-ve; dhe



ç) kur është me rëndësi, të ofruara si një shkarkim i vetëm.

3. Pavarësisht nga sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, ofrimi pa pagesë i grupeve të të dhënave me vlerë të lartë nuk zbatohet për grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe në zotërim të sipërmarrjeve publike, që çojnë në shtrembërim të konkurrencës në tregjet përkatëse, si dhe për bibliotekat, përfshirë bibliotekat universitare, muzetë dhe arkivat.

4. Me vendim të Këshillit të Ministrave, organet e sektorit publik mund të përjashtohen nga detyrimi për ofrimin e të dhënave me vlerë të lartë pa pagesë për një periudhë jo më të gjatë se 2 vjet, në rast se ofrimi i tyre pa pagesë do të kishte ndikim thelbësor në buxhetin e këtyre organeve.

KREU V SHKELJET DHE SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 18

Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Kundërvajtje administrative konsiderohen veprimet e mosveprimet në kundërshtim me këtë ligj si më poshtë:

a) refuzimi i vënies në dispozicion të dokumenteve për ripërdorim në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji dënohet me gjobë nga 100 000 (njëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

b) mospublikimi i tarifave në kundërshtim me pikën 5 të nenit 10 të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

c) mosrespektimi i kërkesave ligjore për kushtet e ripërdorimit/licencës standarde dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

ç) mospublikimi i listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

d) mosbashkëpunimi dhe mosdhënia e informacionit të kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë ligj dënohet me gjobë nga 50

000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Vendosja e masave administrative ndaj organit të sektorit publik ose sipërmarrjes publike që kryen kundërvajtje administrative duhet të jetë proporcionale me dëmin dhe shkeljet e shkaktuara.

3. Në çdo rast, organi i sektorit publik ose sipërmarrja publike brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit mund të bëjë ankim në gjykatë në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

KREU VI KOMPETENCAT E PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 19

Kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e së drejtës për ripërdorim të dokumenteve sipas këtij ligji.

2. Organet e sektorit publik duhet të bashkëpunojnë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke i dhënë të gjithë informacionin që ai kërkon për përmbushjen e detyrave të tij të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 20

Procedura për shqyrtimin e ankesave

1. Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi i sektorit publik ose sipërmarrja publike ka cenuar të drejtën e tyre për ripërdorim të dokumenteve sipas parashikimeve të këtij ligji, ato kanë të drejtë të ankohen në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditësh pune nga dita kur:

a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e ripërdorimit të dokumenteve;



b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e dokumentit për ripërdorim.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditësh pune nga dita kur është dorëzuar ankimi vendos:

a) mospranimin e ankesës kur:

i. ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;

ii. ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;

iii. nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit.

b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e organit të sektorit publik ose të sipërmarrjes publike për të vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar për ripërdorim në mënyrë të plotë ose të pjesshme;

c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;

ç) afatin brenda të cilit organi i sektorit publik ose sipërmarrja publike duhet të zbatojë urdhrin.

4. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t'iu drejtuar gjykatës.

Neni 21

Ankimi në gjykatë

Të gjitha palët e prekura nga vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë të drejtën të ankimojnë këtë vendim në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë.

Neni 22

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10, pika 5; nenit 12, pika 2; nenit 16, pika 2, nenit 17, pika 4, të ligjit.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim nenit 11, pika 2, të ligjit.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Ermonela Felaj (Valikaj)

Miraturar në datën 31.3.2022.

LIGJ

Nr. 34/2022

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË, PËR NEGOCIMIN DHE ZBATIMIN E KONTRATËS ME SHOQËRINË “JONES GROUP INTERNATIONAL”, PËR FORCIMIN E SIGURISË KIBERNETIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është autorizimi dhe përcaktimi i procedurës së veçantë për negociimin, miratimin dhe zbatimin e kontratës me shoqërinë “Jones Group International” (në vijim “Jones Group”) ose një degë të tij, me qëllim forcimin e sigurisë kombëtare, rritjen e aftësisë dhe qëndrueshmërinë e sigurisë kibernetike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përmbajtja e kontratës

1. Kontrata me “Jones Group” ndahet në tri pjesë, si më poshtë:

a) pjesa e parë përfshin shërbimin e hartimit të të gjithë vlerësimit kibernetik dhe certifikimit të nevojshëm ISO dhe/ose SSH EN ISO, të



domosdoshëm për aktivitetet e punës, si një propozim teknik për autoritetin kontraktor;

b) pjesa e dytë përfshin:

i. shërbimin e hartimit të planit të veprimit teknik të nevojshëm për zbatimin e gjetjeve dhe të rekomandimeve të miratuara për secilin institucion nga vlerësimet kibernetike;

ii. dorëzimin dhe/ose implementimin e infrastrukturës fizike, aplikimet software në përputhje me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);

c) pjesa e tretë përfshin projektimin e përcaktimit teknik dhe asistencën teknike për krijimin, zhvillimin, zbatimin dhe funksionimin e Qendrës Shqiptare të Operacioneve të Sigurisë Kibernetike në përputhje me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Për tri pjesët e sipërpërmendura “Jones Group” siguron dhe asiston Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit si autoritetin kontraktor të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë me të gjithë informacionin/ dokumentacionin teknik e ligjor.

2. Kontrata e përcaktuar në pikën 1 përfshin minimalisht kryerjen e aktiviteteve të mëposhtme nga “Jones Group”:

a) vlerësimet gjithëpërfshirëse kibernetike dhe të certifikatave ISO/IEC 27001 për çdo agjenci të qeverisjes civile dhe agjenci të mbrojtjes;

b) hartimin e planeve të transformimit kibernetik për çdo agjenci, pasuar nga zbatimi i rekomandimeve të miratuara nga çdo plan transformimi;

c) dhënien e ndihmës ndaj qeverisë shqiptare dhe agjencive të saj me trajnimin dhe ndërgjegjësimin përkatës për sigurinë kibernetike;

ç) dhënien e ndihmës ndaj qeverisë shqiptare për të krijuar, zhvilluar, zbatuar dhe drejtuar një Qendër Kombëtare të Operacioneve të Sigurisë Kibernetike (në vijim QKOSK) për qeverinë shqiptare dhe agjencitë e saj, përfshirë zhvillimin e teknologjisë dhe të ndërfaqeve të nevojshme;

d) sigurimin e ndihmës për ngritjen e Qendrës Shqiptare të Ekselencës për Sigurinë Kibernetike në Tiranë, në përputhje me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI); dhe

dh) dhënien e rekomandimeve për strukturën, organizimin dhe përgjegjësitë lidhur me sigurinë kibernetike brenda qeverisë shqiptare, QKOSK-ut dhe Qendrës Shqiptare të Ekselencës.

3. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) ka të drejtën dhe detyrimin, sipas këtij ligji, të ndihmojë “Jones Group” me të gjitha të dhënat teknike dhe ligjore të nevojshme të sistemeve të përdorura nga agjencitë shtetërore, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet palëve.

4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për të kryer monitorimin e veprimtarive të aktiviteteve të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, të paraqitura nga “Jones Group” dhe/ose nëpërmjet institucioneve përgjegjëse shqiptare.

Neni 3

Procedura para negociatave

1. Para fillimit të procedurës së negocimit, AKSHI informon “Jones Group” lidhur me të gjitha agjencitë shtetërore, fushëveprimin e tyre, sistemet e tyre në përdorim dhe sigurinë e tyre aktuale kibernetike.

2. Procedura e negocimit realizohet nga komisioni i negocimit, i cili përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Komisioni në përbërje të tij ka përfaqësues të institucioneve, si më poshtë:

a) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë;

b) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen;

c) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për rendin publik;

ç) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë;

d) një përfaqësues i Avokaturës së Shtetit;

dh) një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Certifikimit Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike;

e) një përfaqësues nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

3. Përfaqësuesit e institucioneve të përcaktuara në pikën 2, janë pjesë e kategorisë së nivelit të mesëm drejtues të pajisur me certifikatë sigurie sipas legjislacionit në fuqi.

4. Institucionet e përcaktuara në pikën 2 kanë detyrimin të caktojnë përfaqësuesit e tyre në komisionin e negocimit brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Ngarkohet AKSHI të thërrasë mbledhjen e parë të komisionit të negocimit brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji.



Neni 4

Detyrat dhe detyrimet e komisionit të negocimit

1. Komisioni i negocimit fillon punën në mbledhjen e tij të parë duke verifikuar dërgimin e informacionit, i përcaktuar në pikën 1, të nenit 3, nga AKSHI për “Jones Group”, në cilësinë e kontraktorit në lidhje me këtë ligj.

2. Komisioni i negocimit ka të drejtë të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm nga AKSHI dhe kontraktori, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij ligji.

3. Procedura e negocimit për finalizimin e pjesës së parë dhe të tretë të kontratës kryhet nga AKSHI nëpërmjet grupit negociator, dhe fillon brenda 5 (pesë) ditëve nga dita kur kontraktori do t'i paraqesë AKSHI-t propozimin zyrtar në lidhje me pjesën e parë dhe të tretë të kontratës.

4. Ngarkohet komisioni i negocimit për të negociuar kushtet e kontratës, duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm të qeverisë së Republikës së Shqipërisë në marrjen e shërbimit për rritjen e sigurisë kibernetike të agjencive shtetërore.

5. Komisioni i negocimit asistohet nga një konsulent i përzgjedhur nga Avokatura e Shtetit, sipas procedurave të përcaktuara për këtë qëllim për Avokaturën e Shtetit.

Neni 5

Procedura e negocimit

1. Kontrata nënshkruhet nga AKSHI, në cilësinë e autoritetit kontraktor, si përfaqësues i qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

2. Propozimi zyrtar i “Jones Group” dorëzohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe pjesë e diskutimit të procedurës së negocimit është vetëm projekti i miratuar nga AKSHI.

3. Përpara miratimit të projekteve, pjesë të propozimit zyrtar, AKSHI merr miratimin me shkrim të agjencive, brenda fushës ligjore të përgjegjësisë shtetërore, ku zhvillohen projektet, dhe vetëm pas këtij miratimi ia përcjell komisionit të negocimit për t'u bërë pjesë e kontratës.

4. Komisioni i negocimit ka të drejtë të negociojë kushtet dhe kostot e kontratës, duke mbajtur në konsideratë studimin e tregut që do të kryejë lidhur me këtë procedurë dhe limitin e fondit

që do të vihet në dispozicion për zbatimin e kësaj kontrate.

5. Palët negociojnë dhe bien dakord për kushtet e kontratës me “Jones Group”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga fillimi i periudhës së negociatave. Në rast se palët e finalizojnë kontratën brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë ose afatit të zgjatur me marrëveshje të ndërsjellë, negociatat e kontratës konsiderohen të mbyllura pa asnjë kosto ndërmjet palëve.

6. Pjesë e kontratës është lista e projekteve të miratuara, të cilat zbatohen nga kontraktori nëpërmjet kontratës së posaçme të nënshkruar nga AKSHI dhe kontraktori, siç përmendet në pikën 3, të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 6

Nënshkrimi dhe miratimi i kontratës

1. Autoriteti kontraktor dhe “Jones Group” nënshkruajnë kontratën brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e përfundimit të negociatave.

2. “Jones Group” cakton një nga degët e tij për të nënshkruar kontratën me autoritetin kontraktor, me miratimin e këtij të fundit. Një “degë”, sipas kësaj pike, ka kuptimin e një shoqërie nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose jo të “Jones Group”.

3. Zëvendëskryeministri i paraqet për miratim Këshillit të Ministrave kontratën e nënshkruar në lidhje me projektin, brenda 3 (tri) ditëve pune nga nënshkrimi i saj. Data e hyrjes në fuqi të kontratës për projektin është data e hyrjes në fuqi e vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e kontratës.

Neni 7

Zbatimi i kontratës

1. Me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e kontratës për nënshkrim, referuar pikës 3, të nenit 5, ngarkohet AKSHI për monitorimin e ekzekutimit të kontratës.

2. Pas përfundimit të vlerësimit të sigurisë kibernetike të secilës agjenci dhe dorëzimit të rekomandimeve të planit të transformimit nga “Jones Group”, për të përfshirë koston e propozuar për zbatimin e rekomandimeve, AKSHI përcakton se cili, nëse ka, nga rekomandimet zbatohet e do të drejtojë “Jones Group” që të



vazhdojë në përputhje me financimin e parashikuar për pjesën e dytë të kontratës.

3. Ngarkohet AKSHI, si përfaqësues i agjencisë shtetërore dhe kontraktori, të nënshkruajë kontratë më vete për çdo agjenci shtetërore dhe çdo projekt në zbatim të kontratës së miratuar, të përmendur në pikën 3, të nenit 5, brenda 3 (tre) muajve nga miratimi i saj. Kontrata më vete bazohet në kontratën e miratimit, termat e referencës dhe kostot e projektit të parashikuara dhe të miratuara në kontratën bazë.

4. Zbatimi i kontratës për pjesën e parë fillon menjëherë pas hyrjes në fuqi, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Kjo kontratë përcakton shërbimet e detajuara që do të kryejë “Jones Group”.

5. Për zbatimin e pikës 3, pas miratimit të kontratës nga Këshilli i Ministrave, autoriteti kontraktor krijon një njësi të posaçme për zbatimin e këtij projekti, në të cilën janë të paktën 2 (dy) përfaqësues nga agjencia shtetërore përfituese e projektit. AKSHI emëron kryetarin dhe anëtarët e njësisë së zbatimit të projektit, inxhinierët ekspertë, juristët dhe ekonomistët, të cilët ndjekin zbatimin e çdo kontrate.

Neni 8

Shpenzimet financiare

1. Të gjitha shpenzimet për zbatimin e kontratave sipas këtij ligji mbulohen nga AKSHI.

2. Ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë bën rimbursimin e shpenzimeve për ekspertin ligjor dhe/ose teknik, të përcaktuar në pikën 5, të nenit 4, të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARE

Ermonela Felaj (Valikaj)

Miratuar në datën 31.3.2022.

UDHËZIM

Nr. 8, datë 21.4.2022

PËR ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT FILLOR, VITI SHKOLLOR 2022

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 26 dhe nenit 50, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 23 maj 2022, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.

2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.

3. Për nxënësit e pakicave kombëtare greke dhe maqedonase pjesa e testit që përfshin lëndët e matematikës dhe diturisë së natyrës të jetë në gjuhën e tyre amtare.

4. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10:00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.

5. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet testi.

6. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”, miratuar me urdhrin nr. 78, datë 27.2.2020.

7. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve në përshtatje me programin mësimor me të cilin punojnë, veçoritë dhe standardin e tyre.

8. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.

10. Arkivimi i testeve bëhet pranë zyrave vendore të arsimit parauniversitar.



11. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në DPAP dhe në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

12. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 241, datë 14.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN
NR. 25, DATË 17.1.2019, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PUBLICITETIN E BARNAVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 1, të nenit 55 dhe nenit 56, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar,

URDHËROJ

Në urdhrin nr. 25, datë 17.1.2019, “Për miratimin e rregullores për publicitetin e barnave”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë vijon:

“Për miratimin e rregullores për publicitetin e barnave dhe të barnave homeopatike”.

2. Kudo, në tekstin e rregullores, fjala “barna”, zëvendësohet me togfjalëshin “barna dhe barna homeopatike”.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

URDHËR
Nr. 242, datë 14.4.2022

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
BARNAVE QË TREGTOHEN NË
AGJENCITË FARMACEUTIKE

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 2, të nenit 41, të ligjit nr. 105, datë 31.7.2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së barnave që tregtohen në agjencitë farmaceutike, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor përditëson çdo vit alternativat e reja sipas listës së barnave të rimbursueshme në fuqi, bazuar në regjistrin e barnave të autorizuar për tregtim në Republikën e Shqipërisë, të përditësuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

3. Urdhri nr. 297/2, datë 23.4.2002, “Për listën e barnave që do të tregtohen në Agjencitë Farmaceutike me ndihmës farmacist”, shfuqizohet.

4. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu



LISTA E BARNAVE QË TREGTOHEN ME PAKICË NGA AGJENCITË FARMACEUTIKE

Nr.	Principi aktiv dhe doza	Forma
1	Omeprazole 20 mg	hard caps.
2	Papaverine Hydrochloride 40mg/ml	tret.për inj.
3	Drotaverine Hydrochloride 40 mg	tablet
4	Atropine Sulphate 1 mg - 1 ml	tret.për inj.
5	Butylscopolamine Bromide 10 mg	c.tabl.
6	Metoclopramide 10 mg	tablet
7	Metoclopramide 10mg/2ml	tret.për inj.
8	Acid Ursodeoxycholic 150 mg	hard caps.
9	Acid Ursodeoxycholic 250 mg	hard caps.
10	Lactulose 667 mg/ml	syrup
11	Nystatine 500.000 Nj.N	tablet
12	Sulfasalazine 500 mg	tablet
13	Mesalazine 500 mg	c.tabl.
14	Multienzymes (L+A+P) Pancreatin 10.000 Nj.N	capsul
15	Multienzymes (L+A+P) Pancreatin 25.000 Nj.N	capsul
16	Insuline Humane Biosintetike Neutrale 100 Nj.N. / ml - 3 ml	pre-filled pen.
17	Insuline Humane Biosintetike Izofane 100 Nj.N. / ml - 3 ml	pre-filled pen.
18	Insuline Humane Biosintetike Bifazike Izofane 100 Nj.N/ ml - 3 ml 25/75	pre-filled pen.
19	Metformin 500 mg	f.c.tabl.
20	Metformin 850 mg	f.c.tabl.
21	Metformin 1000 mg	f.c.tabl.
22	Glibenclamide 5 mg	tablet
23	Vitamina A + Vitamina D (10000/10000 Nj.N)/ 1ml	pika nga goja
24	Cholecalciferol 14400 NjN/ml	pika nga goja
25	Cholecalciferol 200000 NjN - 1 ml	tret.për inj.
26	Thiamine 50 mg/ml	tret.për inj.
27	Acid Ascorbic 100 mg/ 2 ml	tret.për inj.
28	Nicotinamide 200 mg	tablet
29	Pyridoxine 100 mg/ 2 ml	tret.për inj.
30	Acenocoumarol 4 mg	tablet
31	Acid Acetylsalicylic 100mg	f.c.tabl.
32	Ferrous Fumarate eq. to 115mg Iron	hard cap.
33	Ferrous Sulphate eq. to 80 mg Iron	tablet
34	Ferric Sodium Gluconate Complex 62,5mg/8ml - 240ml	syrup
35	Cyanocobalamin 100 mcg/ml	tret.për inj.
36	Cyanocobalamin 500 mcg/ml	tret.për inj.
37	Acid Folic 5 mg	tablet
38	Magnesium Sulphate 2.5g/10ml	tret.për inj.
39	Digoxin 0.25 mg	tablet
40	Propafenone 150 mg	f.c.tabl.
41	Propafenone 300 mg	f.c.tabl.
42	Amiodarone 200 mg	tablet
43	Glyceryl Trinitrate 0.5 mg	tablet subling.
44	Isosorbite Dinitrate 10 mg	tablet
45	Isosorbite Mononitrate 40 mg	tablet
46	Isosorbite Mononitrate 20 mg	tablet
47	Methyldopa 250 mg	f.c.tabl.
48	Hydrochlorothiazide 25 mg	tablet
49	Furosemide 40 mg	scored tab.
50	Furosemide 20 mg/2ml	tret.për inj.
51	Furosemide 25 mg	tablet



52	Spironolactone 25 mg	tablet
53	Spironolactone 50 mg	tablet
54	Triamteren+Hydrochlorthiazide 50 + 25mg	tablet
55	Spironolactone + Furosemide 50 + 20 mg	capsul
56	Propranolol 40 mg	tablet
57	Metoprolol 50mg	f.c.tabl.
58	Metoprolol 100mg	f.c.tabl.
59	Atenolol 100 mg	f.c.tabl.
60	Bisoprolol 5 mg	f.c.tabl.
61	Bisoprolol 10 mg	f.c.tabl.
62	Nebivolol 5 mg	tablet
63	Carvedilol 6.25 mg	tablet
64	Carvedilol 25 mg	tablet
65	Carvedilol 12.5mg	tablet
66	Amlodipine 5 mg	tablet
67	Amlodipine 10 mg	tablet
68	Felodipine 5 mg	prlg.tab.
69	Felodipine 10 mg	sgr.c.tab.
70	Nifedipine 10 mg	tablet
71	Nifedipine 20 mg	sust.relea.tab
72	Nifedipine 30 mg	prlg.tab.
73	Nifedipine 60 mg	prlg.tab.
74	Nitrendipine 20 mg	f.c.tabl.
75	Lercanidipine 10 mg	f.c.tabl.
76	Lercanidipine 20 mg	f.c.tabl.
77	Verapamil 40 mg	f.c.tabl.
78	Verapamil 80 mg	c.tabl.
79	Diltiazem 60 mg	tablet
80	Diltiazem 90 mg	tablet
81	Captopril 25 mg	tablet
82	Captopril 50 mg	tablet
83	Enalapril 20 mg	tablet
84	Ramipril 5 mg	tablet
85	Ramipril 10 mg	tablet
86	Fosinopril 10 mg	f.c.tabl.
87	Zofenopril 30 mg	tablet
88	Fosinopril + Hydrochlorthiazide 20 + 12,5 mg	f.c.tabl.
89	Enalapril+Lercanidipine 20+10mg	f.c.tabl.
90	Losartan Potassium 50mg	f.c.tabl.
91	Valsartan 80 mg	f.c.tabl.
92	Valsartan 160mg	f.c.tabl.
93	Irbesartan 150 mg	f.c.tabl.
94	Irbesartan 300 mg	f.c.tabl.
95	Olmesartan 20 mg	f.c.tabl.
96	Olmesartan 40mg	f.c.tabl.
97	Valsartan + Hydrochlorthiazide 80 + 12.5 mg	f.c.tabl.
98	Valsartan+Hydrochlorthiazide 160 + 25 mg	f.c.tabl.
99	Irbesartan + Hydrochlorthiazide 150 + 12.5 mg	f.c.tabl.
100	Irbesartan + Hydrochlorthiazide 300 + 12.5 mg	f.c.tabl.
101	Irbesartan + Hydrochlorthiazide 300 + 25 mg	f.c.tabl.
102	Simvastatine 10 mg	f.c.tabl.
103	Simvastatine 20 mg	f.c.tabl.
104	Simvastatine 40 mg	f.c.tabl.
105	Lovastatine 20 mg	prlg.tab.



106	Fluvastatin 80mg	f.c.tabl.
107	Atorvastatine 10 mg	f.c.tabl.
108	Atorvastatine 20mg	f.c.tabl.
109	Fenofibrate 200 mg	f.c.tabl.
110	Fenofibrate 160 mg	hard caps.
111	Ciprofibrate 100 mg	f.c.tabl.
112	Amlodipine + Atorvastatin 5 + 10 mg	f.c.tabl.
113	Amlodipine + Atorvastatin 10 + 10 mg	tablet
114	Terbinafine 250 mg	tablet
115	Bacitracine 500 Nj.N /g + Neomycin 3500 Nj.N/g - 30 g	pomade
116	Silver Sulfadiazine 10 mg/g	krem
117	Acid Hyaluronic+Silver Sulfadiazine 0.2%+1% -25g	krem
118	Betamethasone Dipropionate 0.5 mg/g 15 g	pomade
119	Betamethasone 0.1% 15 g	pomade
120	Betamethasone Dipropionate 0.5mg/ 20 g	pomade
121	Methylprednisolone Aceponate 0,1g/100g 15 g	krem
122	Methylprednisolone Aceponate x 0,1g/100g 15 g C	krem
123	Flumetasone 0.02%+ Neomycine 0.05 % 15g	ovule
124	Chloramphenicol+Metronidazole+Nystatin+Hydrocortizone Acetate 200mg/500mg/660000Nj.N/15mg	ovule
125	Metronidazol 500 mg	ovule
126	Econazol Nitrate 150 mg	ovule
127	Fenticonazole Nitrate 600 mg	ovule
128	Nifuratel 500 mg + Nystatine 200.000 Nj.N	tablet
129	Bromocriptine 2.5 mg	tret.për inj.
130	Testosterone Enanthate 250 mg/ml	tret.për inj.
131	Progesterone 25 mg/ml	tablet
132	Acid Nalidiksik 500 mg	prlg.cap.
133	Tamsulosine 0.4mg	hard cap.
134	Terazosine 2mg	tablet
135	Terazosine 5mg	f.c.tabl.
136	Tetracosactide Hexaacetate 1 mg /1 ml	nasal spray
137	Desmopressin 0.01 mg/ml	tablet
138	Dexamethasone 0.5 mg	pika nga goja
139	Dexamethasone Sodium Phosphate 0.2% - 10 ml	tret.për inj.
140	Dexamethasone Phosphate 4 mg/ml	tret.për inj.
141	Prednisolone 25 mg/2 ml	tret.për inj.
142	Prednisone 5 mg	tablet
143	Triamcinolone 40 mg -1ml	tret.për inj.
144	Methylprednisolone 125 mg	tablet
145	Levothyroxine Sodium 50mcg	tablet
146	Levothyroxine Sodium 100mcg	tablet
147	Levothyroxine Sodium 200mcg	tablet
148	Propylthiouracil 50 mg	tablet
149	Thiamazole 5 mg	capsul
150	Doxycycline 100 mg	tablet
151	Oxytetracycline 250 mg	pluhur për susp.
152	Ampicilline 125 mg / 5 ml - 100ml	capsul
153	Ampicilline 500 mg	capsul
154	Ampicilline 1g	pluhur për inj.
155	Amoxicilline 125 mg / 5 ml - 100 ml	pluhur për susp.
156	Amoxicilline 250 mg / 5 ml - 60 ml	capsul
157	Amoxicilline 250 mg	capsul
158	Amoxicilline 500 mg	hard cap.



159	Amoxicilline Trihydrate + Acid Clavulonic (250+62.5)mg/5ml-100 ml	pluhur për susp.
160	Amoxicilline Trihydrate + Acid Clavulonic 375 mg	f.c.tabl.
161	Amoxicilline Trihydrate+ Acid Clavulonic 625mg	f.c.tabl.
162	Amoxicilline Trihydrate+Acid Clavulonic (457mg/5ml-70ml)	pluhur për susp.
163	Amoxicilline Trihydrate+Acid Clavulonic 1000mg	f.c.tabl.
164	Cephalexine 250 mg / 5ml - 100 ml	granul. for susp.
165	Cephalexin 500 mg	hard cap.
166	Cefuroxime Axetil 125 mg / 5 ml - 50 ml	granul. for susp.
167	Cefaclor Monohydrate 125 mg / 5 ml - 60 ml	pluhur për susp.
168	Cefaclor Monohydrate 250 mg / 5 ml - 100 ml	pluhur për susp.
169	Cefaclor 500 mg	caps.
170	Sulfamethoxazole +Trimethoprim 240 mg / 5 ml - 100 ml	tablet
171	Sulfamethoxazol 400 mg + Trimethoprine 80 mg	tablet
172	Sulfamethoxazole +Trimethoprim 800mg + 160mg	f.c.tabl.
173	Erythromycine 250 mg	flakon
174	Erythromycine 250 mg/5ml	tablet
175	Spiramycine 250 mg	f.c.tabl.
176	Clarithromycine 250 mg	f.c.tabl.
177	Clarithromycine 500 mg	f.c.tabl.
178	Clarithromycine 125mg/5ml-100ml	pluhur për susp.
179	Azithromycine 200 mg / 5ml - 20 ml	pluhur për susp.
180	Azithromycine 250 mg	hard cap.
181	Gentamicin 40 mg - 2 ml	solu.për inj.
182	Gentamicin 80 mg - 2 ml	tret.për inj.
183	Ciprofloxacin 250 mg	f.c.tabl.
184	Ciprofloxacin 500 mg	f.c.tabl.
185	Metronidazol 250 mg	tablet
186	Nitrofurantoin 100 mg	capsul
187	Fluconazole 150 mg	hard cap.
188	Fluconazole 100mg	hard caps.
189	Aciclovir 400 mg	tablet
190	Aciclovir 800 mg	tablet
191	Indometacin 100 mg	gastro-resis.tab.
192	Diclofenac 50 mg	c.tabl.
193	Piroxicam 20 mg	tablet
194	Ibuprofen 400 mg	f.c.tabl.
195	Naproxen 250 mg	f.c.tabl.
196	Naproxen 500 mg	f.c.tabl.
197	Ketoprofen 50 mg	suppos
198	Ketoprofen 100 mg	f.c.tabl.
199	Naproxen Sodium + Codein Phosphate 550 + 30 mg	tablet
200	Allopurinol 100 mg	tablet
201	Metamizole 50 % -2 ml	tret.për inj.
202	Paracetamol 125mg	suppos
203	Paracetamol 250 mg	suppos
204	Phenobarbital 15 mg	tablet
205	Phenobarbital 60 mg	tablet
206	Clonazepam 2 mg	syrup
207	Carbamazepine 100mg/5ml -100 ml	tablet
208	Carbamazepine 200 mg	slow release tabl.
209	Acid Valproic 300mg	prlg.tabl.
210	Acid Valproic 500mg	prlg.tabl.
211	Acid Valproic 380mg/10ml-150ml	tablet
212	Trihexyphenidyl 5 mg	tablet



213	Levodopa 250 mg + Carbidopa 25 mg	tablet
214	Levodopa 200 mg + Benserazide 50 mg	tablet
215	Amantadine 100 mg	hard cap.
216	Chlorpromazine 100 mg	tret.për inj.
217	Chlorpromazine 50 mg - 2 ml	sgr.c.tab.
218	Levomepromazine 25 mg	pika nga goja
219	Haloperidol 2 mg/ml	pika nga goja
220	Haloperidol 50 mg - 1ml	tablet
221	Clozapine 100 mg	tablet
222	Lithium Carbonate 250 mg	tablet
223	Diazepam 5 mg	c.tabl.
224	Diazepam 10 mg /2 ml	sgr.c.tab.
225	Chlordiazepoxide 10 mg	tablet
226	Lorazepam 1 mg	tablet
227	Lorazepam 2.5 mg	tablet
228	Meprobamate 400 mg	sgr.c.tab.
229	Imipramine 25 mg	sgr.c.tab.
230	Clomipramine 25 mg	sgr.c.tab.
231	Amitriptyline Hydrochloride 25 mg	f.c.tabl.
232	Pyrantel Embonate 125 mg	f.c.tabl.
233	Pyrantel Embonate 250 mg	syrup
234	Pyrantel Embonate 125 mg/2.5ml - 15ml	nasal spray
235	Beclomethasone 100 mcg - 200 doza	pompe
236	Salbutamol 0.1mg - 200 doza Inhalacion	pompe
237	Salmeterol Xinofoate 25 mcg/doze - 120 doza inh.	pompe
238	Formoterol Fumarate 12mcg	caps.per inhal.
239	Beclometasone 250 mcg /Inhalacion -200 doze	pompe
240	Fluticasone Propionate 50 mcg -120 doza	pompe
241	Fluticasone Propionate 250 mcg-60 doza	pompe
242	Fluticasone Propionate 125mcg-120 doza	pompe
243	Fluticasone Propionate 250 mcg/doze - 120 doza	pompe
244	Fluticasone Propionate 500mcg-60 doza	syrup
245	Salbutamol 2mg / 5 ml -150ml	syrup
246	Salbutamol Sulphate 4 mg	capsul
247	Theophylline 200 mg Retard	sgr.c.tab.
248	Aminophylline 100 mg	tret.për inj.
249	Aminophylline 240 mg/2 ml	tablet
250	Codeine 15 mg	sgr.c.tab.
251	Promethazine 25 mg	f.c.tabl.
252	Cetirizine Hydrochloride 10mg	f.c.tabl.
253	Loratadine 10 mg	tablet
254	Loratadine 5 mg/5ml-120 ml	syrup
255	Ketotifen 1mg	hard cap.
256	Ketotifen 1mg/5ml-100 ml	pika për sy
257	Gentamicine 0.3%/10ml	pika për sy
258	Travoprost + Timolol (40 mcg + 5 mg/1ml - 2.5 ml)	pika për sy
259	Diclofenac Natriumi 1% - 5ml	pomade për sy
260	Dexamethasone +Neomycine 3.5gr	pika për sy
261	Dexamethasone Sodium Phosphate 1mg/ml - 5ml	pika për sy
262	Pilocarpine Hydrochloride 2 % - 10 ml	tablet
263	Acetazolamide 250 mg	pika për sy
264	Brinzolamide 10mg/ml-5ml	pika për sy
265	Timolol 0.5%-5ml	pika për sy
266	Travoprost 40mcg/ml-2.5 ml	pika për sy



267	Atropine Sulphate 1%-10ml	pika për sy
268	Potassium Iodide 200 mcg	amp.
269	Aqua Bidestillata 2 ml	amp.
270	Aqua Bidestillata 5ml	amp.
271	Aqua Bidestillata 10ml	

URDHËR**Nr. 243, datë 14.4.2022**

**PËR PËRCAKTIMIN E BARNAVE QË
MJEKËT DHE STOMATOLOGËT
RUAJNË NË KLINIKAT E TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 45, pika 2, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mjekët dhe stomatologët të ruajnë dhe përdorin në klinikat e tyre barna në lloje e sasi të mjaftueshme vetëm për ndihmën urgjente ose për procedurat e nevojshme, që lidhen me ushtrimin e profesionit.

2. Në ambientet e një kabineti ose klinike dentare, materialet dhe barnat që janë të lejuara të disponohen janë të gjitha ato materiale dhe barna që janë pjesë e protokollit të mjekimit në dentistri dhe specialitetet, si më poshtë vijon:

- terapi stomatologjike (endodonti);
- ortopedi dhe protetike dentare;
- periodontologji;
- ortodonci;
- kirurgji dentare.

3. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror të hartojë protokollin dhe udhëzimet, sipas parashikimeve të këtij urdhri, brenda datës 30 maj 2022, dhe të njoftojë ofruesit e shërbimeve për protokollin dhe udhëzimet.

4. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror të njoftojë Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për listën e barnave sipas protokolleve dhe udhëzimeve.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për monitorimin dhe inspektimin e listës së barnave sipas protokolleve dhe udhëzimeve të miratuara.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri struktura përgjegjëse për farmaceutikën pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

NJOFTIM**Nr. 5491, datë 22.4.2022**

**MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE DYPALËSHE ME
BASHKIMIN EVROPIAN**

Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Evropa Krijuese (2021–2027), nënshkruar më datë 6.12.2021, në Tiranë, ka hyrë në fuqi më datë 15.4.2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

NJOFTIM**Nr. 5497, datë 26.4.2022**

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit, ka hyrë në fuqi më 19 prill 2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi



VENDIM
Nr. 75, datë 13.4.2022

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2021**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 486/4 prot., datë 11.4.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar–shkurt–mars 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj nr. 631 prot., datë 1.2.2022, paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 32.75 lekë/kwh për muajin janar 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Me shkresën nr. 728 prot., datë 4.2.2022, shoqëria FSHU sh.a. paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18.8 lekë/kwh për muajin janar 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- ERE, me shkresën nr. 213/1 prot., datë 15.2.2022, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë përllëgaritjet e saktësuara të kostove administrative për vitin 2022, të cilat lidhen me kryerjen e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, duke i ndarë ato nga kostot direkte të FSHU sh.a., në mënyrë të tillë që këto kosto të alokohen në mënyrë korrekte ndaj klientëve

fundorë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 6, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”. Gjithashtu, ERE ka kërkuar paraqitjen e pasqyrave të plota financiare të shoqërisë për vitin 2021, duke evidentuar në formë analitike të ardhurat dhe shpenzimet operative të FSHU sh.a., të ndara nga ato që shërbejnë për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

- ERE, me shkresën nr. 266 prot., datë 15.2.2022, i është drejtuar shoqërisë KESH sh.a. dhe ka vënë për dijeni MIE-n dhe FSHU sh.a., duke kërkuar plotësimin informacioni dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

- Në vijim të përgjigjes së ardhur me shkresën nr. 939/2 prot., datë 23.2.2022, nga shoqëria KESH sh.a., bashkëlidhur së cilës është vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit nr. 1349/1, datë 16.2.2022, “Mbi miratimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2022 dhe parashikimi 2023–2026”, dhe në pikën 1, të këtij vendimi përcaktohet se: “çmimi i shitjes së energjisë elektrike për FMF - klientë tariforë do të jetë 12 lekë/kwh”, ERE i është drejtuar me kërkesë për interpretim shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me sasinë e blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF.

- ERE, me shkresën nr. 213/2 prot., datë 28.2.2022, ka kërkuar paraqitjen e aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në përputhje me përcaktimet e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020. Kjo kërkesë i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a., duke pasur parasysh se:

- në komunikimet e paraqitura nga shoqëria, bashkëlidhur aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin janar 2022, për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i



Mundësisë së Fundit, KESH sh.a. pritët të vendosë në dispozicion sasinë e energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve që shërbejnë në kushtet e mundësisë së fundit me çmimin për njësi prej 12 lekë/kwh;

- neni 8, i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, të ndryshuar, përcakton se llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit kryhet bazuar në “CBET” çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes për sasinë e energjisë së siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF, për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi;

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021, vendosi ndër të tjera të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, është parashikuar se në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të drejtës së klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre për furnizimin me energji elektrike, për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, të cilët nuk kanë një tarifë të miratuar nga ERE, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e lëvruar bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekë/kwh, të miratuar nga ERE.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën nr. 1513/3 prot., datë 28.3.2022, në kuadër të nevojës për saktësimin e përcaktimeve të akteve që rregullojnë marrëdhëniet mes shoqërisë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të KESH sh.a. nr. 2612/1, datë 25.3.2022, ku miratohet se në tabelën, pjesë e vendimit nr. 1, datë 19.1.2022, të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a., në të cilën thuhet se: “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF - klientë tariforë” saktësohet në “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF - klientë tariforë të furnizuar në nivel tensioni deri 20 kV”.

- Lidhur me gjithë sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 1395/2 prot., datë 31.3.2022, i është përgjigjur vetëm kërkesës së ERE mbi saktësimin e sasisë së blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF, ndërsa për sa i përket kërkesave të tjera të ERE-s mbi problematikat e konstatuara në aplikimet e paraqitura për miratim, ende nuk ka një përgjigje nga ana e FSHU sh.a.

- Në shkresën e sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a. deklaron se: “.. Për sa më sipër, në kushtet kur sasia e energjisë së blerë nga KESH sh.a. me çmimin 12 lekë/kwh ka shërbyer vetëm për klientët FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV, për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF 35 kV FSHU sh.a. ka siguruar energjinë elektrike në treg të lirë. Në varësi të çmimit të blerjes së energjisë elektrike, si dhe bazuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 201/2017, i ndryshuar, ka rezultuar çmimi i diferencuar për të dyja kategoritë FMF 35 kV dhe 6/10/20 kV, për të cilat është kryer aplikimi për miratim pranë ERE-s.

- Në kushtet e saktësimit nga ana e shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., mbi sasinë e energjisë elektrike të shitur shoqërisë FSHU sh.a. për furnizimin me energji elektrike për klientët që shërbejnë nga FMF-ja, ERE, me qëllim miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajt janar–shkurt–mars 2022, vlerëson që deri në paraqitjen e kostove administrative të cilat i shërbejnë shoqërisë FSHU sh.a. për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, të vijojë të përdorë koston administrative prej 1.79 lekë/kwh për llogaritjen e çmimit të energjisë elektrike të FMF-së për muajt janar–shkurt–mars 2022.

- Kostot administrative për muajt janar 2022, deri në paraqitjen e informacionit të kërkuar nga ERE, do të vijojë të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekë/kwh.

- Me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, Bordi i ERE-s, ndër të tjera, vendosi:

- të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022”, e cila është 0.75 lekë/kwh;



- të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 233, datë 19.11.2021, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2022”, të cilat do të jenë:

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV do të jetë 1,5 lekë/kWh;

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20 kV do të jetë 3,9 lekë/kWh;

- tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes do të jetë 4,79 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, aplikimeve të FSHU sh.a., si dhe llogaritjeve të ERE-s, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse si më poshtë vijon:

Sipas Përlllogaritjeve të ERE Çmimi i FMF-së për muajin Janar 2022 sipas Niveleve të Tensionit

		Nivelet e tensionit		
		35 kV	20 Kv	10/06 kV
Njësia				
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	27.88	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84	0.36
Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante		Leke/kWh	28.72	12.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	3.9
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRrTSHt + CA		Leke/kWh	32.76	18.80
				19.69

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2022, do të jetë:

- 32.76 lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18.80 lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20 kV;

- 19.69 lekë/kWh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2022, prej:

- 32.76 lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18.80 lekë/kWh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20kV;

- 19.69 lekë/kWh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli

VENDIM
Nr. 76, datë 13.4.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes të energjisë elektrike



nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 386/4 prot., datë 11.4.2022, nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar–shkurt–mars 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 1393 prot., datë 2.3.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 32.85 lekësh/kwh për muajin shkurt 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- FSHU sh.a., me shkresën nr. 1395 prot., datë 2.3.2022, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18.8 lekësh/kwh për muajin shkurt 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- ERE, me shkresën nr. 213/1 prot., datë 15.2.2022, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë përllogaritjet e saktësuar të kostove administrative për vitin 2022, të cilat lidhen me kryerjen e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, duke i ndarë ato nga kostot direkte të FSHU sh.a., në mënyrë të tillë që këto kosto të alokohen në mënyrë korrekte ndaj klientëve fundorë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 6, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”. Gjithashtu, ERE ka kërkuar paraqitjen e pasqyrave të plota financiare të shoqërisë për vitin 2021, duke evidentuar në formë analitike të ardhurat dhe shpenzimet operative të FSHU sh.a., të ndara nga ato që shërbejnë për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

- ERE, me shkresën nr. 266 prot., datë 15.2.2022, i është drejtuar shoqërisë KESH sh.a. dhe ka vënë për dijeni MIE-n dhe FSHU sh.a., duke kërkuar plotësim informacioni dhe vënie në

dispozicion të dokumentacionit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

- Në vijim të përgjigjes së ardhur me shkresën nr. 939/2 prot., datë 23.2.2022, nga shoqëria KESH sh.a., bashkëlidhur së cilës është vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1349/1, datë 16.2.2022, “Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2022 dhe parashikimi 2023–2026”, dhe ku në pikën 1, të vendimit përcaktohet, se: “çmimi i shitjes së energjisë elektrike për FMF-klientë tariforë do të jetë 12 lekë/kwh”, ERE i është drejtuar me kërkesë për interpretim shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me sasinë e blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF.

- ERE, me shkresën nr. 213/2 prot., datë 28.2.2022, ka kërkuar paraqitjen e aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për klientët të cilët shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në përputhje me përcaktimet e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020. Kjo kërkesë i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a., duke pasur parasysh se:

- Në komunikimet e paraqitura nga shoqëria, bashkëlidhur aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin janar 2022, për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, KESH sh.a. pritet të vendosë në dispozicion sasinë e energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve që shërbehen në kushtet e mundësisë së fundit me çmimin për njësi prej 12 lekësh/kwh;

- Neni 8, i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, të ndryshuar, përcakton se llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit kryhet bazuar në “CBET” çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes për sasinë e



energjisë së siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi.

- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021, vendosi ndër të tjera të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a. për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022. Në vendimin e Bordit të ERE nr. 213, datë 15.12.2020, është parashikuar se në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të së drejtës së klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre për furnizimin me energji elektrike, për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, të cilët nuk kanë një tarifë të miratuar nga ERE, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e livruar, bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekësh/kwh, të miratuar nga ERE.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën nr. 1513/3 prot., datë 28.3.2022, në kuadër të nevojës për saktësimin e përcaktimeve të akteve që rregullojnë marrëdhëniet mes shoqërisë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE, vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të KESH sh.a. nr. 2612/1, datë 25.3.2022, ku miratohet se në tabelën pjesë e vendimit 01, datë 19.1.2022, të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a., në të cilën thuhet: “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF – klientë tariforë” saktësohet në “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF – klientë tariforë të furnizuar në nivel tensioni deri 20 kV”.

- Lidhur me gjithë sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 1395/2 prot., datë 31.3.2022, i është përgjigjur vetëm kërkesës së ERE-s mbi saktësimin e sasisë së blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF, ndërsa për sa u përket kërkesave të tjera të ERE-s, mbi problematikat e konstatuara në aplikimet e paraqitura për miratim, ende nuk ka një përgjigje nga ana e FSHU sh.a.

- Në shkresën e sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a. deklaron, se: “... Për sa më sipër, në kushtet kur sasia e energjisë e blerë nga KESH sh.a., me çmimin 12 lekë/kwh ka shërbyer vetëm për klientët

FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV, për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF 35 kV FSHU sh.a. ka siguruar energjinë elektrike në treg të lirë. Në varësi të çmimit të blerjes së energjisë elektrike, si dhe bazuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë Së Fundit”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 201/2017, të ndryshuar, ka rezultuar çmimi i diferencuar për të dyja kategoritë FMF 35 kV dhe 6/10/20 kV, për të cilat është kryer aplikimi për miratim pranë ERE-s.

- Në kushtet e saktësimit nga ana e shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., mbi sasinë e energjisë elektrike të shitur shoqërisë FSHU sh.a., për furnizimin me energji elektrike për klientët që shërbehen nga FMF, ERE, me qëllim miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajt janar–shkurt–mars 2022, vlerëson që deri në paraqitjen e kostove administrative, të cilat i shërbejnë shoqërisë FSHU sh.a. për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, të vijoje të përdorë koston administrative prej 1.79 lekësh/kwh për llogaritjen e çmimit të energjisë elektrike të FMF për muajt janar–shkurt–mars 2022.

- Kostoja administrative për muajin shkurt 2022, deri në paraqitjen e informacionit të kërkuar nga ERE, do të vijoje të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekësh/kwh.

- Me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, Bordi i ERE-s ndër të tjera vendosi:

- Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022” është 0.75 lekë/kwh.

- Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 233, datë 19.11.2021, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2022”, të cilat do të jenë:

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV do të jetë 1,5 lekë/kwh;

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20 kV do të jetë 3,9 lekë/kwh;

- tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes do të jetë 4,79 lekë/kwh.



- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, aplikimeve të FSHU sh.a., si dhe llogaritjeve të ERE-s, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si më poshtë vijon:

Sipas Përlllogaritjeve të ERE Çmimi i FMF-së për muajin Shkurt 2022 sipas Niveleve të Tensionit

			Nivelet e tensionit		
			35 kV	20 Kv	10/06 kV
		Njësia			
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	27.97	12.00	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84	0.36	0.36
	Çmimi mesatar i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	28.81	12.36	12.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	3.90	4.79
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRrTSHt+CA			32.85	18.80	19.69

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2022 do të jetë:

- 32.85 lekë/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.80 lekë/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20 kV;
- 19.69 lekë/kwh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2022, prej:

- 32.85 lekësh/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.80 lekësh/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20kV;
- 19.69 lekësh/kwh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli

VENDIM Nr. 77, datë 13.4.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2021

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimet e Bordit nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; nenit 15 të



“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 486/4 prot., datë 11.4.2022 nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajt janar–shkurt–mars 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 2071 prot., datë 31.3.2022, paraqiti aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 32.92 lekësh/kwh për muajin mars 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Me shkresën nr. 2072 prot., datë 31.3.2022, shoqëria FSHU sh.a. paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18.8 lekësh/kwh për muajin mars 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- ERE, me shkresën nr. 213/1 prot., datë 15.2.2022, ka kërkuar nga shoqëria FSHU sh.a. të paraqesë përllogaritjet e saktësuar të kostove administrative për vitin 2022, të cilat lidhen me kryerjen e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, duke i ndarë ato nga kostot direkte të FSHU sh.a., në mënyrë të tillë, që këto kosto të alokohen në mënyrë korrekte ndaj klientëve fundorë, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 6, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”. Gjithashtu, ERE ka kërkuar paraqitjen e pasqyrave të plota financiare të shoqërisë për vitin 2021, duke evidentuar në formë analitike të ardhurat dhe shpenzimet operative të FSHU sh.a., të ndara nga ato që shërbejnë për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

- ERE, me shkresën nr. 266 prot., datë 15.2.2022, i është drejtuar shoqërisë KESH sh.a. dhe ka vënë për dijeni MIE-n dhe FSHU sh.a., duke kërkuar plotësimin informacioni dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit,

transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

- Në vijim të përgjigjes së ardhur me shkresën nr. 939/2 prot., datë 23.2.2022, nga shoqëria KESH sh.a., bashkëlidhur së cilës është vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 1349/1, datë 16.2.2022, “Mbi miratimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë KESH sh.a për vitin 2022 dhe parashikimi 2023–2026” dhe ku në pikën 1, të vendimit përcaktohet, se: “çmimi i shitjes së energjisë elektrike për FMF-klientë tariforë do të jetë 12 lekë/kwh”, ERE i është drejtuar me kërkesë për interpretim shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me sasinë e blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF.

- ERE, me shkresën nr. 213/2 prot., datë 28.2.2022, ka kërkuar paraqitjen e aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, në përputhje me përcaktimet e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, të ndryshuar, si dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020. Kjo kërkesë i është drejtuar shoqërisë FSHU sh.a., duke pasur parasysh se:

- Në komunikimet e paraqitura nga shoqëria, bashkëlidhur aplikimit për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin janar 2022, për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, KESH sh.a. pritet të vendosë në dispozicion sasinë e energjisë së nevojshme për furnizimin e klientëve, që shërbehen në kushtet e mundësisë së fundit me çmimin për njësi prej 12 lekësh/kwh;

- Neni 8, i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 233, datë 20.12.2019, të ndryshuar, përcakton se llogaritja e çmimit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit kryhet bazuar në “CBET” çmimin mesatar të ponderuar të profileve të blerjes për sasinë e energjisë së siguruar për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi.



- Bordi i ERE-s, me anë të vendimit nr. 252, datë 21.12.2021, vendosi ndër të tjera të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, deri në përfundimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a., për tarifën e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2022. Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, është parashikuar se në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të së drejtës së klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre për furnizimin me energji elektrike, për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, të cilët nuk kanë një tarifë të miratuar nga ERE, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e livruar bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekësh/kwh, të miratuar nga ERE.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën nr. 1513/3 prot., datë 28.3.2022, në kuadër të nevojës për saktësimin e përcaktimeve të akteve që rregullojnë marrëdhëniet mes shoqërisë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. ka përcjellë në ERE, vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të KESH sh.a. nr. 2612/1, datë 25.3.2022, ku miratohet se në tabelën pjesë e vendimit 01, datë 19.1.2022, të Këshillit Mbikëqyrës të KESH sh.a, në të cilën thuhet: “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF – klientë tariforë” saktësohet në “çmimi i shitjes për klientët tariforë të FMF – klientë tariforë të furnizuar në nivel tensioni deri 20 kV”.

- Lidhur me gjithë sa më sipër, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 1395/2 prot., datë 31.3.2022, i është përgjigjur vetëm kërkesës së ERE mbi saktësimin e sasisë së blerë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF, ndërsa për sa u përket kërkesave të tjera të ERE-s, mbi problematikat e konstatuara në aplikimet e paraqitura për miratim, ende nuk ka një përgjigje nga ana e FSHU sh.a.

- Në shkresën e sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a. deklaron se: “... Për sa më sipër, në kushtet kur sasia e energjisë e blerë nga KESH sh.a., me çmimin 12 lekë/kwh ka shërbyer vetëm për klientët FMF të lidhur në nivel tensioni 6/10/20 kV, për mbulimin e kërkesës së klientëve FMF 35 kV FSHU sh.a. ka siguruar energjinë elektrike

në treg të lirë. Në varësi të çmimit të blerjes së energjisë elektrike, si dhe bazuar në “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë Së Fundit”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 201/2017, të ndryshuar, ka rezultuar çmimi i diferencuar për të dyja kategoritë FMF 35 kV dhe 6/10/20 kV, për të cilat është kryer aplikimi për miratim pranë ERE-s.

- Në kushtet e saktësimit nga ana e shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., mbi sasinë e energjisë elektrike të shitur shoqërisë FSHU sh.a. për furnizimin me energji elektrike për klientët që shërbehen nga FMF-ja, ERE, me qëllim miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajt janar–shkurt–mars 2022, vlerëson që deri në paraqitjen e kostove administrative, të cilat i shërbejnë shoqërisë FSHU sh.a. për ushtrimin e funksionit të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, të vijojë të përdorë koston administrative prej 1.79 lekësh/kwh për llogaritjen e çmimit të energjisë elektrike të FMF për muajt janar–shkurt–mars 2022.

- Kostoja administrative për muajin mars 2022, deri në paraqitjen e informacionit të kërkuar nga ERE, do të vijojë të jetë në të njëjtën vlerë si viti i kaluar, prej 1,79 lekësh/kwh.

- Me vendimin nr. 252, datë 21.12.2021, Bordi i ERE-s, ndër të tjera, vendosi:

- Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 212, datë 15.12.2020, “Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022” është 0.75 lekë/kwh.

- Të shtyjë fuqinë juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 213, datë 15.12.2020, të Bordit të ERE-s, “Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE nr. 233, datë 19.11.2021, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes për vitin 2022”, të cilat do të jenë:

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV do të jetë 1,5 lekë/kwh;

- tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20 kV do të jetë 3,9 lekë/kwh;

- tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes do të jetë 4,79 lekë/kwh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga



Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, aplikimeve të FSHU sh.a., si dhe llogaritjeve të ERE-s, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si më poshtë vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Mars 2022

MARS 2022			Nivelet e tensionit		
			35 kV	20 kV	10/6 kV
	Njësia		Çmimi	Çmimi	Çmimi
CBEt	të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	28.042	12.00	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84	0.36	0.36
Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante		Leke/kWh	28.88	12.36	12.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	3.90	4.79
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA		Leke/kWh	32.92	18.80	19.69

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin mars 2022, do të jetë:

- 32.92 lekë/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18.80 lekë/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20 kV;

- 19.69 lekë/kwh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin MARS 2022, prej:

- 32.92 lekësh/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 35 kV;

- 18.80 lekësh/kwh për klientët FMF në nivelin e tensionit 20 kV;

- 19.69 lekësh/kwh për klientët FMF në nivelet e tensionit 10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli

VENDIM
Nr. 79, datë 13.4.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “M.C INERTE LUMZI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”; dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen



e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/12 prot., datë 8.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 28.2.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 70/5 prot., datë 1.2.2022, bëri njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 15.3.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k. rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin për aplikim, në përputhje me “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b” “c” dhe “d”: plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” “c” dhe “d”: plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b” dhe “c”: plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli

VENDIM
Nr. 80, datë 13.4.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN
ENERGY BILISHT” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të



datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 434/10 prot., datë 8.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Green Energy Bilisht’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448 prot., datë 4.4.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2000 kw.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b”, plotësuar;

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “e”, “g”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “a”, “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.4.2, 4.4.3, germat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.4.4, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, plotësuar;

- Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5, germa “b”, plotësuar.

- Në lidhje me dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE edhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Korçë për administratorin dhe shoqërinë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., duke qenë se kjo e fundit ka seli vetëm në këtë qark;

- germa “f” (marrëveshje koncesione apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, si dhe ndryshim të këtyre akteve), pa plotësuar.

Sa rezulton nga shkresa e protokolluar në ERE me nr. 467 prot., datë 5.4.2022, MIE ka miratuar ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë fotovoltaike me kapacitet 2 mw, ku ndër ta renditet edhe shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k., e cila në vijim duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen respektive të nënshkruar me MIE-n në vijim të miratimit të dhënë.

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “b” (bilance financiare të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)), plotësuar pjesërisht.

Duke konsideruar faktin se bilancet e vitit 2021 duhet të kenë përfunduar deri në 31 mars 2022, atëherë do t’i kërkohej shoqërisë t’i depozitojë ato në ERE për nevoja të kësaj vendimmarrjeje;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera), plotësuar pjesërisht.

Shoqëria ka paraqitur një shprehje interesi nga banka, e cila daton gati përpara një viti, për këtë arsye do t’i kërkohej shoqërisë të bëjë me dije nëse ka vijuar me nënshkrimin e ndonjë kontrate kredie me bankën për të siguruar investimin për 80% të vlerës që do të investohen nga banka dhe nëse po, ta dokumentojë në ERE, në kuadër të plotësimit të kërkesave të kësaj pike të rregullores. Po ashtu do



t'i kërkohej shoqërisë të bëjë me dije se si do të mbulojë 20 % të vlerës së investimit, pasi edhe nga pasqyrat financiare shoqëria rezultoi me humbje.

Dokumentacionin tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.1.4:

Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat për centralin prodhues dhe emrin e centralit, sipas kërkesave të formatit përkatës.

Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5:

- germa "a" (miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit), plotësuar pjesërisht.

Duke qenë se në "Miratimin për pikë lidhje central fotovoltaik" nr. 66/3 prot., datë 7.1.2022, është konstatuar një gabim material (dokumenti i drejtohet shoqërisë "Green Energy Bilisht" sh.p.k., por në tekst përmendet shoqëria "Sun Beat System" sh.p.k.), shoqëria duhet të saktësojë këtë gabim material. Po ashtu, shoqëria duhet të përcjellë në ERE, të nënshkruar, marrëveshjen e lidhjes së re, pasi nga ky dokument konstatohet se mungon vula dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të shoqërisë "Green Energy Bilisht" sh.p.k.

- Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet e ndërtimit apo fazën e zhvillimit të centralit fotovoltaik.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të centralit fotovoltaik 2 mw, propozuar për ndërtim nga shoqëria "Green Energy Bilisht" sh.p.k., rezultoi se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Green Energy Bilisht" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2000 kw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Maksim Shuli

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 72, datë 13.4.2022, "Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022, përkatësisht në bazën ligjore, bëhen korrigjimet si më poshtë:

Paragrafi i fundit ndryshon, si më poshtë vijon:

"... Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 486/1 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022–2024".

Paragrafi 2 bëhet:

"Procesi i shqyrtimit të aplikimit ka kaluar nëpërmjet rishikimit të vazhdueshëm të kërkesës për të ardhura nga OST sh.a., fillimisht me kërkesën drejtuar në ERE, me anë të shkresës nr. 5215 prot., datë 31.8.2021 dhe, më tej, përditësimin tij me anë të shkresave nr. 5215/1 prot., datë 5.10.2021, nr. 5215/3 prot., datë 4.11.2021 dhe nr. 6901/3 prot datë 23.12.2021."

Paragrafi 17 bëhet.

"Të ardhurat e kërkuara, që priten të realizohen nga OST sh.a., janë llogaritur për periudhën rregullatore 2022–2024 dhe tarifa e re të transmetimit të energjisë elektrike, e cila do t'i shtrijë efektet nga data 1 maj 2022, është



përlogaritur duke konsideruar dhe diferencën e korigjueshme të të ardhurave të kërkuara për periudhën janar–prill 2022, për efekt të rikuperimit të të ardhurave të pafaturuara në 4-mujorin e parë. Kjo diferencë nuk ndikon në tarifën mesatare të transmetimit për periudhën 2022–2024 dhe do të korigjohet në zbritje të të ardhurave të kërkuara në vitin e dytë të periudhës rregullatore.”

Paragrafi 18 bëhet:

“Tarifat e transmetimit të energjisë elektrike për çdo vit të periudhës rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezultojnë: a) 0.85 lekë/kwh për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2022; b) 0.89 lekë/kwh për vitin 2023; c) 0.83 lekë/kwh për vitin 2024.”

Paragrafi 19 bëhet:

“Nga sa më sipër, tarifa e transmetimit për periudhën rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, rezulton 0.85 lekë/kwh.”

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 73, datë 13.4.2022, “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit, për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022, përkatësisht në bazën ligjore, bëhet korigjimi, si më poshtë:

Paragrafi i fundit ndryshon si më poshtë vijon:

“... Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 486/2 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, sipas nivelit të tensionit për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022.”

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 74, datë 13.4.2022, “Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.5.2022–31.12.2022”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 15.4.2022, përkatësisht në bazën ligjore, bëhen korigjimet si më poshtë:

Paragrafi i fundit ndryshon si më poshtë vijon:

“... Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.4.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.486/3 prot., datë 11.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve “Mbi vlerësimet e ERE-s për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.5.2022–31.12.2022.”

Paragrafi 9 bëhet:

“Kostot administrative të aktivitetit të furnizimit të përlogaritura për FSHU sh.a., për periudhën 1 maj–31 dhjetor 2022 janë vlerësuar 1.06 lekë/kwh.”

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë